




Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria për Administratë
Zyra e Prokurimit
Nr 03/ 20
Datë : 30-05- 2024.

KONTRATË PROKURIMI NR 13

(KONTRATË PUBLIKE KORNIZË)

62500-24-3801-1-2-1/C791

KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;
dhe

KosovaMed Healthcare SH.P.K., me seli në Rrugen Ndue Përlleshi K.P. Lok. Nr.1 Prishtinë me numer biznesi 810866759, (në vazhdim "Furnizuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontrate publike për furnizim me:

**OBJEKTI I KONTRATËS : FURNIZIM ME FILMA PËR RO, MAMOGRAFI, VETPROGRAM
DHE ORTOPAN PËR NEVOJAT E QKMF-së Dr „SHPETIM ROBAJ” NË MALISHEVË
me numër identifikues: 62500-24-3801-1-2-1**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontrate publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave në vijim:

FURNIZIM ME FILMA PËR RO, MAMOGRAFI, VETEPGRAM DHE ORTOPAN PËR NEVOJAT E QKMF-së DR.SHPETIM ROBAJ MALISHEVË

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë mallëratë përmendura në 1.1. .

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 29.05.2024 dhe përfundon në datën 28.05.2026

Neni 2

Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë **TRI (3)** ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë QKMF Dr., SHPETIM ROBAJ¹⁷ MALISHEVË

2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi.

Vlera totale indikative e kontratës është **28,940.00€ me fjalë (njëzetëetëtmijëenëntëqindëekaterdhjetëeuro)** euro. Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht.

4.2. Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës publike kornizë.

4.3. Çmimet per njësi janë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë kornizë.

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) *[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].*

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.


6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët SHQIPE në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Besnik Krasniqi	Emri:	Kastriot Asllani
Pozita:	Menagjer i Prokurimit	Pozita:	Preritor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	29/05/2024	Data:	
Vula:		Vula:	

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: **62500-24-3801-1-2-1/C791**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Nr. Nenit</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	1.1	Gjuha e përdorur do të jetë : SHQIPE.
Siguria e ekzekutimit	2	10 % e vlerës së kontratës për 25 muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës.
Fillimi i furnizimit	3	Fillimi i furnizimit me material shpenzues per RO, Mamografi,Vetprogram dhe Ortopan per nevojat e QKMF-së Dr „Shpetim Robaj” në Malishevë do të behet duke u bazuar në kerkesen e AK – menagjerit të kontratës.
Afati i furnizimit	4	OE Furnizimin me material shpenzues per RO, Mamografi,Vetprogram dhe Ortopan per nevojat e QKMF-së Dr Shpetim Robaj në Malishevë duhet ta e kryej në afatë prej 24 muaj që nga dita e nënshkrimit të kontratës.
Obligimet e OE	5	OE pa pranimin e kerkeses se AK – menagjerit te kontrates nuk mund te kryej asnje furnizim. OE mbas pranimiit te kerkeses se AK – menagjerit të kontratës duhet te kryej furnizimin me material shpenzues per RO, Mamografi,Vetprogram dhe Ortopan ne sasin e kerkuar. Çdo kerkese e menaxherit te kontrates se AK lidhur me furnizimin me shpenzues per RO, Mamografi,Vetprogram dhe Ortopan duhet te realizohet ne afatë sa më të shpejtë por jo me gjatë se tri (3) ditë nga dita e pranimiit te kerkeses.

Menaxhimi i Kontrates	6	Menaxhimi i kontratës do ta bëjë zyrtari i QKMF-së z.Shqipdon Krasniqi i caktuar nga ZKA i AK-së. Menaxheri i kontratës është përgjegjës për mbikqyrjen e ekzekutimit të furnizimit me material shpenzues për RO, Mamografi, Vetprogram dhe Ortopan gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të furnizimit e deri në përfundim të kontratës. Menaxheri i projektit do të mbikqyrë OE gjatë tërë kohës sa zgjatë furnizimi duke filluar nga dita e parë e deri në përfundimin e kontratës përkatësisht ekzekutimin e kontratës. Qëllimi i mbikqyrjes është të kontrollojë cilësinë dhe sasinë e furnizimit. AK e ruan të drejtën që t'ia ndërprej kontratën me OE për mos realizimin e kontratës në cilësi dhe sasinë në afatë dhe në përputhje të plotë me specifikacionin e ofertës .
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	7	Të gjitha i përkasin OE.
Cilësia e furnizimeve	8	Furnizimin me material shpenzues për RO, Mamografi, Vetprogram dhe Ortopan për nevojat e QKMF-së Dr „Shpëtim Robaj ” në Malishevë duhet të kryhet në cilësi dhe sasi të kërkuar nga AK dhe në përputhëshmeri të plotë në specifikacionin e ofertës. Nëse furnizimi nuk kryhet në cilësi dhe sasi të kërkuar do të i kthehet OE dhe shpenzimet e bëra do të bien në llogari të OE.
Pagesa	9	<u>Pagesa do të bëhet në Euro.</u> Obligohet AK që pasi ta e pranon raportin e pranimi të furnizimit me material shpenzues për RO, Mamografi, Vetprogram dhe Ortopan për nevojat e QKMF-së Dr.“ Shpëtim Robaj ” në Malishevë nga zyrtari z.Shqipdon Krasniqi (menaxheri i kontratës) si dhe faturen nga OE të ia paguaj shumen sipas nenit 4 dhe 4.1 të kësaj kontrate.
Dorëzimi	10	Vendi i dorëzimit të Furnizimit me material sanitar do të jetë në QKMF Dr.“Shpëtim Robaj” në Malishevë.
Vonesat në ekzekutim	11	Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të kryej furnizimin brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe

		datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	12	Komisioni për ndërmjetësim pranë Ministrisë së Drejtësisë.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	13	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë.

Komuna e Malishevës

Drejtoria për Shëndetësis Punë dhe Mirëqenie Sociale

FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES PËR RO,MAMOGRAFI,VETERPROGRAM DHE ORTOPAN PËR NEVOJAT E QKMF-së DR.SHIPËTIM ROBAJ MALISHEVË

Nr. Rend	Pershkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi me TVSH	Totali me Tvsh
1	Medical dry film 35x43	Cop	2000	2.40	4,800.00
2	Medical dry film 25x30	Cop	4600	1.90	8,740.00
3	Medical dry film 20x25	Cop	6000	2.20	13,200.00
4	Medical dry film për Ortopan di-nl 20x25	Cop	2000	1.10	2,200.00
TOTALI:					28,940.00